



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 1865/1 prot.

Tiranë, më 11 .03 2019

Lënda: Kthim përgjigje shkresës suaj të datës 28.02.2019

**Z. FATMIR HOXHA**  
**Rruga "Fadil Rada", godina 7-katëshe, Hyrja D, Ap. 9**  
**Njësia Bashkiake nr. 2**  
**Tiranë**

I nderuar z. Hoxha,

Me cilësinë e Kryetares së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ju vë në dijeni se u njoha me shkresën tuaj të datës 28.02.2019, protokolluar me tonën nr. 1865 prot., datë 28.02.2019, me anë të së cilës keni vënë në dispozicion materiale të vendimmarrjes së trupit gjykues që ka rivlerësuar çështjen tuaj, ku pretendohet shkelja disiplinore e komisionerit Xhensila Pine dhe kërkohet fillimi i procedimit disiplinor ndaj saj.

Pas shqyrtimit të objektit të kërkesës suaj dhe provave bashkëlidhur, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vlerëson se nuk janë përmbushur kriteret për fillimin e një procedimi disiplinor.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

